



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 1024/prot.

Tiranë, më 05.12.2025

**VENDIM**  
Nr. 73, datë 05.12.2025

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 58, DATË 16.10.2024**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 58, datë 16.10.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Vau Dejës dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës",

**KONSTATOVA SE:**

Me urdhrin nr. 44, datë 21.03.2024, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Vau Dejës", ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, në institucionin Bashkia Vau Dejës..

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 58, datë 16.10.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Vau Dejës dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës", ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, me Urdhrin nr. 88, datë 13.10.2025, "Kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e vendimeve paralajmëruese të Komisionerit nr. 22, datë 13.2.2025; nr. 5, datë 22.1.2024; nr. 46, datë 26.7.2024; nr.

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-Hotel Drini, Tiranë, Tel: 00355 4268141, Web: [www.kmshc.al](http://www.kmshc.al) E-mail: [info@kmshc.al](mailto:info@kmshc.al)

52, datë 20.9.2024; nr. 58, datë 16.10.2024 dhe nr. 132, datë 8.11.2024”, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 58, datë 16.10.2024, në institucionin Bashkia Vau Dejës, sipas drejtimeve të programit të mbikëqyrjes në vazhdim nr. 854/1, datë 13.10.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës me shkresën nr. 853 prot., date 13.10.2025, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit nr. 58, datë 16.10.2024 të Komisionerit”. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes dhe në përfundim të procesit mbajti një akt konstatimi ku u pasqyrua situata e rregullimit të ligjshmërisë dhe u administrua dokumentacioni që materializon zbatimin pjesërisht të vendimit objekt i këtij verifikimi.

Mbikëqyrja në subjekt u krye në datat 10-14 nëntor 2025. Në përfundim të procesit, grupi i punës mbajti një procesverbal, ku u evidentua situata në lidhje me ecurinë e masave të marra nga institucioni.

Më tej, me qëllim lehtësimin e procesit dhe sigurimin e një zbatimi sa më efektiv të detyrave të përcaktuara, është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me njësinë përgjegjëse të subjektit, si nëpërmjet korrespondencës elektronike, ashtu edhe përmes komunikimeve telefonike, duke ofruar asistencën e nevojshme për sqarimin e paqartësive të hasura gjatë procesit të zbatimit të plotë të vendimit të Komisionerit.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 58, datë 16.10.2024, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt, përfshirë komunikimin shkresor dhe atë elektronik (me e-mail), situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 2 të vendimit paralajmërues, Komisioneri kërkon që njësia përgjegjëse të organizojë procesin e plotë të klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, duke ngritur grupin e punës, mbledhur dhe analizuar informacionin për çdo pozicion, hartuar përshkrimet e punës, përgatitur dokumentacionin për vlerësim dhe ngritur Komitetin e Vlerësimit, i cili në bashkëpunim me DAP harton listën përfundimtare të klasifikimit, mbi bazën e së cilës miratohet plani i rekrutimit dhe plani i veprimtimit për zbatimin e vendimit.

Nga dokumentacioni i administruar në institucion, konstatojmë se procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil është zhvilluar në përputhje me aktet e mëposhtme, të renditura:

1. Shkresa me lëndë “Njoftim” nr. 150 prot., datë 28.10.2024, përmes së cilës Njësia përgjegjëse ka njoftuar nëpunësit civilë për fillimin e procesit të ristrukturimit.
2. Urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr. 703, datë 19.11.2024, për ngritjen e Komitetit të Vlerësimit për vlerësimin dhe klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil.
3. Shkresa nr. 6998/1 prot., datë 19.12.2024, me të cilën Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka hartuar dhe miratuar listën përmbledhëse të pozicioneve

të punës të klasifikuara në kategorinë dhe klasën përkatëse, duke përfshirë përsëritjen e përgjithshme të detyrave dhe kërkesat minimale për çdo pozicion.

4. Vendimi nr. 2, datë 29.01.2025, për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil.

Nga shqyrtimi i këtyre akteve konstatohet se institucionit i është formalizuar njoftimi fillestar i procesit të ristrukturimit, është ngritur Komiteti i Vlerësimit, është hartuar dhe miratuar lista përmbledhëse e pozicioneve të klasifikuara dhe është miratuar plani vjetor i pranimeve, duke përmbushur një pjesë të detyrimeve të përcaktuara në vendimin paralajmërues.

Në pikën 3 të vendimit paralajmërues kërkohet që, pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, Kryetari i Bashkisë të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për 7 pozicionet drejtuese të zëna në kundërshtim me ligjin dhe të përsërisë nga fillimi procedurën e konkurrimit për plotësimin e tyre

Nga dokumentacioni i administruar në institucion, rezultoi se për pozicionet “Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore”, “Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile” dhe “Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar” nuk janë administruar masa apo dokumente që të materializojnë ndërmarrjen e veprimeve për procedimin me konkurrim, sipas kërkesave të vendimit paralajmërues.

Për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit dhe Financës” është administruar Akti i largimit nr. 7169 prot., datë 02.12.2024, i cili provon ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe krijon kushtet për vijimin e procedurës së konkurrimit.

Në lidhje me pozicionet “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”, “Përgjegjës në Sektorin e Medias, Informimit Publik dhe Statistikës” dhe “Drejtor i Burimeve Njerëzore”, rezultojnë se procedurat e konkurrimit janë zhvilluar dhe dokumentuar me aktet përkatëse, konkretisht:

- Shpallja nr. 2614 prot., datë 19.04.2024, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”;
- Shpallja nr. 3134 prot., datë 09.05.2024, për pozicionin “Drejtor i Burimeve Njerëzore”;
- Shpallja nr. 295 prot., datë 16.01.2024, për pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Medias”;

si edhe aktet përfundimtare të emërimit:

- Akti nr. 3549 prot., datë 31.05.2024, për pozicionin “Drejtor i Burimeve Njerëzore”;
- Akti nr. 3548 prot., datë 31.05.2024, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore”;
- Akti nr. 50 prot., datë 20.02.2024, për pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Medias”.

Këto akte provojnë përmbushjen e detyrimeve procedurale vetëm për tre pozicionet e sipërpërmendura, ndërsa për pozicionet e mbetura nuk u administruan veprime që të realizuar

ializojnë nisjen apo zhvillimin e procedurës së konkurrimit, duke e lënë këtë pjesë të detyrimit në proces të papërbushur.

**Në pikën 4** të këtij vendimi paralajmërues Komisionieri i kërkon Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për 78 punonjës të emëruar me akte të përkohshme, të nxjerra në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil, si dhe të rregullojë pasojat ligjore, me qëllim që pozicionet përkatëse të jenë efektivisht të lira në momentin e shpalljes së tyre për konkurrim pranë AKPA, në respektim të parimeve të shanseve të barabarta, profesionalizmit dhe transparencës. Ky veprim synon rivendosjen e ligjshmërisë dhe mundësimin e një procesi rekrutimi të rregullt dhe të standardizuar në përputhje me kërkesat e ligjit. Bëhet fjalë për pozicione të cilat aktualisht janë të zëna nga punonjës të emëruar përkohësisht me akte të pavlefshme.

Nga dokumentacioni i administruar në institucion dhe nga gjetjet e pasqyruara në Aktin e Konstatimit, rezultoi se për pjesën më të madhe të 78 pozicioneve të punës të zëna me akte të përkohshme emërimi, të evidentuara si të nxjerra në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil, Kryetari i Bashkisë nuk ka kryer konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve përkatëse dhe as rregullimin e pasojave ligjore, siç kërkohet nga pika 4 e vendimit paralajmërues, me qëllim që pozicionet të jenë efektivisht të lira në momentin e shpalljes për konkurrim pranë AKPA. Megjithatë, për një grup rastesh është ndërmarrë tashmë ndërprerja e marrëdhënieve financiare me institucionin, ndërsa për rastet e tjera njësia përgjegjëse ka njoftuar se ndërprerja e marrëdhënieve financiare do të realizohet në datën 12.11.2025, sipas planifikimit të brendshëm administrativ.

#### **Në vijim paraqiten rastet individuale të evidentuara:**

- **Mark Zhuri**, emëruar me urdhrin nr. 736, datë 01.08.2023, në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”; i është ndërprerë marrëdhënia financiare me aktin nr. 438, datë 01.07.2025.
- **Zef Pashuku**, emëruar me urdhrin nr. 349, datë 31.08.2022, në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Bujqësisë dhe MT*”; i është ndërprerë marrëdhënia financiare me aktin nr. 15, datë 14.01.2025.
- **Gjovalin Pacaj**, emëruar me aktin nr. 10, datë 08.01.2024, në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Investimeve dhe Projekteve Publike*”; i është ndërprerë marrëdhënia financiare me aktin nr. 106, datë 28.02.2025.
- **Vanin Groshi**, emëruar me aktin nr. 868, datë 15.09.2023, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Investimeve dhe Projekteve Publike*”; i është ndërprerë marrëdhënia financiare me aktin nr. 531, datë 07.08.2024.
- **Ajet Mlloja**, emëruar me aktin nr. 496, datë 27.10.2022, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Investimeve dhe Projekteve Publike*”; i është ndërprerë marrëdhënia financiare me aktin nr. 648, datë 21.10.2024.
- **Marinela Deda**, emëruar me aktin nr. 270, datë 18.04.2024, në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë Juridike, Integritet, Prokurimeve dhe Aseteve*”; pas përfundimit të konkurrimit është emëruar me aktin nr. 6, datë 12.08.2025.
- **Eriona Kolçe**, emëruar me aktin nr. 789, datë 17.08.2023, në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Integritet European*”; pas përfundimit të konkurrimit është emëruar me aktin nr. 5, datë 12.08.2025.

- **Pjetër Përgjegjaj**, emëruar me aktin nr. 207, datë 06.03.2024, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Mbrojtjes dhe Inspektimit të Kullotave*”; i është ndërprerë marrëdhënia financiare me aktin nr. 680, datë 13.10.2025.
- **Saimir Topalli**, emëruar me aktin nr. 40, datë 05.02.2020, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit*”; i është ndërprerë marrëdhënia financiare me aktin nr. 749, datë 04.11.2025.
- **Prenda Sejdia**, emëruar me aktin nr. 953, datë 09.10.2023, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Protokollit dhe Arkivës*”; i është ndërprerë marrëdhënia financiare me aktin nr. 690, datë 14.10.2025.
- **Nikolin Përzeffi**, emëruar me aktin nr. 128, datë 05.02.2024, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Mbrojtjes, Parandalimit dhe Mbulimit të Terrenit*”; i është ndërprerë marrëdhënia financiare me aktin nr. 738, datë 31.10.2025.
- **Lindita Hasani**, emëruar me aktin nr. 129, datë 05.02.2024, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Mbrojtjes, Parandalimit dhe Mbulimit të Terrenit*”; i është ndërprerë marrëdhënia financiare me aktin nr. 650, datë 30.09.2025.
- **Eva Bujari**, emëruar me aktin nr. 291, datë 24.04.2024, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe PAK*”; i është ndërprerë marrëdhënia financiare me aktin nr. 629, datë 14.10.2025.
- **Xhuana Kaci**, është emëruar në pozicionin “*Drejtor i Burimeve Njerëzore*” me aktin nr. 3549 prot., datë 31.05.2024, në përfundim të procedurës së konkurrimit.

**Raste për të cilat njëzia përgjegjëse deklaroi se marrëdhëniet financiare do të ndërpriten në datën 12.11.2025:**

- **Arben Dodani**, i emëruar me urdhrin nr. 172, datë 13.04.2023, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Mbrojtjes dhe Inspektimit në Pyje dhe Kullota*”.
- **Ilgena Canga (Mardoda)**, e emëruar me urdhrin nr. 26, datë 08.07.2022, në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Planifikimit Urban dhe Sekretarisë Teknike*”.
- **Kloida Dodani**, e emëruar me urdhrin nr. 23, datë 08.07.2022, në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Shëndetësisë*”.
- **Blerim Rraboshta**, i emëruar me urdhrin nr. 90, datë 01.03.2023, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Integritit European*”.
- **Nikolin Leka**, i emëruar me urdhrin nr. 905, datë 21.09.2023, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Ndihmës Ekonomike dhe PAK*”.
- **Anila Filipi**, e emëruar me urdhrin nr. 833, datë 04.09.2023, në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Protokollit dhe Arkivës*”.
- **Paola Marku**, e emëruar me urdhrin nr. 1006, datë 25.10.2023, në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e GIS dhe Kadastrës*”.

Në pikën 5 të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri kërkon nga ana e njësisë përgjegjëse dhe subjekteve të tjera të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil për rregullimin e situatës së administrimit të shërbimit civil, të rregullohet situata në lidhje me institutin e konfirmimit dhe deklarimit pas periudhës së provës për punonjëset, *Manjola Marku dhe Merisida Meti*.

Rezulton se, me anë të shkresës nr. 5598/3 prot., datë 20.11.2024, njëzia përgjegjëse ka informuar Komisionerin për zbatimin e kësaj pike të vendimit në lidhje me nëpunësen Manjola Marku. Në këtë kuadër, është përcaktuar se gjatë periudhës së provës ajo do të ishte nën mbikëqyrjen e nëpunësit civil Albert Ndoci, i cili në përfundim të periudhës ka

hartuar raportin e vlerësimit të datës 15.05.2023, dhe ka shprehur dakordësinë për konfirmimin dhe deklarin e statusit të saj si nëpunëse civile në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Buxhetit dhe Financës*”. Për shkak se pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar ka qenë vakant, vendimi për konfirmimin dhe deklarin e statusit është kryer nga njësia përgjegjëse.

Po ashtu, në këtë shkresë gjindet informacioni i dërguar nga njësia përgjegjëse në lidhje me procedurën që është ndjekur për nëpunësen Merisida Meti. Është përcaktuar se gjatë periudhës së provës ajo ka qenë nën mbikëqyrjen e nëpunësit civil Desbi Shkoza, i cili në përfundim të periudhës ka hartuar raportin e vlerësimit të datës 07.07.2023 dhe ka shprehur dakordësinë për konfirmimin dhe deklarin e statusit të saj si nëpunëse civile. Edhe për këtë rast, për shkak të vakancës në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar, vendimi për konfirmimin dhe deklarin e statusit është kryer nga njësia përgjegjëse.

**Në pikën 6**, i është kërkuar Njesisë së Burimeve Njerëzore që dosjet e personelit të të plotësohen në rregull sipas përcaktimeve ligjore, ku për rastet e evidentuara me mungesa të raportit mjekësor, të plotësohet dosja e personelit me këto akte, sipas kërkesave të ligjit.

Grupi i punës, përmes verifikimit të disa dosjeve të përzgjedhura rastësisht, konstatoi se kërkesa e kësaj pike është plotësuar, pasi dokumentacioni i munguar rezultoi i administruar në dosjet përkatëse të punonjësve. Gjatë kontrollit u vlerësua se dokumentet e kërkuara:

- përfshirë raportet mjekësore dhe aktet e tjera të detyrueshme procedurale;
- janë vendosur në përputhje me standardet e përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil.

Verifikimi tregoi se dosjet janë sistemuar dhe dokumentacioni është arkivuar sipas praktikës së saktë administrative.

**Në përfundim**, në bazë të të gjitha gjetjeve të paraqitura më sipër, vlerësoj se Bashkia Vau Dejës ka zbatuar vetëm pjesërisht rekomandimet e përcaktuara në Vendimin Paralajmëruar nr. 58, datë 16.10.2024, të Komisionerit.

Sa i takon dy aspekteve më problematike që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil dhe rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, vlen të theksohet se nga institucioni kanë filluar të merren masa.

Duke qenë se këto nuk janë procese të lehta dhe kërkojnë një periudhë kohore të domosdoshme përtej afatit paralajmëruar të përcaktuar nga Komisioneri, si dhe mbështetur në faktin se njësia përgjegjëse ka shfaqur paqartësi në njohjen dhe më tej zbatimin e saktë të ligjit lidhur me procesin e ristrukturimit, si dhe pozicionet e plotësuar në kundërshtim me ligjin nuk janë përfshirë të gjitha në planin e rekrutimit, me synim plotësimin e tyre në përputhje të plotë me procedurat ligjore, vlerësoj se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe mbikëqyrjes së orientuar për strukturat e bashkive. Në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk

adresohen plotësisht, institucioni mund të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme ose tematike gjatë vitit 2026.

Në këto kushte, vlerësoj se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 58, datë 16.10.2024, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Vau Dejës dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”.
2. Ndjekjen e detyrave të pazbatuara, të evidentuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Vau Dejës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



